

Raport mbi gjendjen e mbrojtjes së Trashëgimisë Botërore – Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Ohrit

Republika e Maqedonisë së Veriut është plotësisht e përkushtuar ndaj Vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Kulturore me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve më urgjente të specifikuara në Rekomandimet dhe nga Misioni Monitorues Reaktiv në vitin 2017.

Disa nga masat korigjuese dhe aktivitetet e kërkuara të cilët janë të lidhur me përmbushjen e rekomandimeve tashmë janë zbatuar, dhe disa pritet të finalizohen gjatë vitit 2022, si dhe të zbatohen në periudhën vijuese.

Kronologjia e aktiviteteve të ndërmarra nga MMJPH:

- Më 21 janar të vitit 2020, pas mendimit të mëparshëm të Komisionit Kombëtar të UNESCO-s, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Planin për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 45/20).
- Gjatë periudhës raportuese, Komisioni për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit, në të cilin marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në vazhdimësi edhe me intensitet të pazvogëluar zbatoi kompetencat e tij në monitorimin dhe zbatimin e Planit të Menaxhimit të Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit si dhe monitorimi i gjendjes me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajon.
- Më datë 27.11.2020, Komiteti Bilateral për Menaxhimin e Liqenit të Ohrit – organ mbajti mbledhjen e dytë ku u diskutua dhe u pranua Draft-Plani i Menaxhimit të Pellgut të Liqenit të Ohrit, i cili është i zhvilluar plotësisht në përputhje me Direktivën Kornizë Evropiane për Ujërat (2000/60/EC) dhe legjislacioni kombëtar përkatës në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut.
- Më 19.07.2021 është miratuar Vendimi për mbrojtjen e përkohshme (deri në shpalljen zyrtare të zonës së mbrojtur) të Kënetës së Studençicës (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 164/21).
- Janë përgatitur dhe janë mbajtur debate publike për ligjin për Kënetën e Studençicës.
- Në maj të vitit 2021, Liqeni i Ohrit dhe Kënetë e Studençicës i janë shtuar listës Ramsar si zonë e re.
- Më 22.09.2021, kryetarët e komunave të Ohrit, Strugës dhe Debrcës kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët në mbështetje të Studimit për Valorizimin e Liqenit të Ohrit, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në procesin e shpalljes së Liqenit të Ohrit për Monument të Natyrës.
- Qeveria e RMV-së nga seanca e 117-të e mbajtur më 02.11.2021, ka ngarkuar Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor deri në fund të janarit 2022, deri tek Qendra e Trashëgimisë Botërore të propozojë një draft zonë kontakti / bufer në kufijtë e rajonit të Ohrit. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve kanë ndërmarrë aktivitete duke formuar Komisionin. Ky aktivitet është në zhvillim.

- Për të mbuluar borxhin e NP Sistem Kolektor ndaj komunës së Strugës, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2021 siguroi mjete financiare në vlerë prej 60.000.000 denarë.
- Është hartuar dhe miratuar Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Galiçica 2021-2030.
- Për të përmbushur detyrimet të cilat rrjedhin nga Vendimi i Komitetit të Trashëgimisë Botërore 44.COM 7B.77 (Fuzhou, Kinë 2021), gjegjësisht rekomandimet nga Misionet Monitoruese Reaktive nga viti 2017 dhe 2020, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 09.11.2020, miratoi vendimin për formimin e GRUPIT PUNUES për hartimin e Propozim-Planit Strategjik për rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit.
- Ky grup punues ka zhvilluar takime koordinuese me palën shqiptare në datat 27 prill dhe 27 maj. Është hartuar draft versioni fillestar i Planit Strategjik me një plan veprimi dhe e njëjta është publikuar në ueb faqen e MMJPH-së (25 tetor) dhe është e disponueshme në linkun vijues: <https://bit.ly/3A9bk4M>.
- Është përgatitur VSM (Vlerësim Strategjik Mjedisor) për Planin Strategjik për rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit, si dhe është miratuar Vendim për moszbatimin e vlerësimit strategjik nga MMJPH më datë 06.10.2022.
- Në platformën ZOOM më 21 nëntor 2022, nga ora 12:00 deri në orën 14:00 do të mbahet debat publik mbi Draft-Versionin e Planit Strategjik për rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit. Linku për pjesëmarrje do të publikohet në ueb faqen e MMJPH-së dhe në rrjetet sociale.
- Më 27 prill 2022, në Pogradec, Shqipëri, është zhvilluar takim i përbashkët pune në nivel politik në mes të dy vendeve, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes me Shqipërinë për menaxhimin e Liqenit të Ohrit, me të cilin është planifikuar rivitalizimi i Komitetit Bilateral për Mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, si organ për menaxhim. Qëllimi i këtij takimi është një marrëveshje nga të dyja palët për zyrtarizimin e anëtarësimit në Komitetin e Përbashkët për Menaxhimin e Rajonit të Ohrit – UNESCO Trashëgimia Botërore në nivel ministror, dhe në nivel të kryetarëve. Për këtë qëllim dhe në përputhje me **rekomandimin – 3a** të Vendimit të Komitetit të Trashëgimisë Botërore 44.COM 7B.77 (Fuzhou, Kinë 2021), ku kërkohet “Ngritja e profilit të anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit me pellgun ndërkuftar” me qëllim ngritjen e kompetencave vendimmarrëse të Komitetit, MMJPH përgatiti Informatë për Qeverinë e RMV-së me Propozim-Vendimin për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Menaxhimin e Pellgut të Liqenit të Ohrit në mes të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariati i saj, i njëjti është në fazën e mendimit.
- Më 06.08.2022 NP Sistem Kolektor – Ohër deri tek MMJPH dorëzoi kërkesë për financimin e aktiviteteve në vitin 2023 për rehabilitimin dhe sanimin e sistemit kolektor për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit në vlerë prej 565.461.348,00 denarë.
- Më 19.08.2022, MMJPH zhvilloi një takim online me përfaqësuesit e NP Sistem Kolektor – Ohër dhe një kompani spanjolle për të rishikuar dokumentacionin teknik të NP Sistem Kolektor, për një investim të mundshëm të përbashkët për rehabilitimin dhe ndërtimin shtesë të këtij sistemi.

- Me qëllim ridrejtimit e shtratit të lumit Sateska në rrjedhën e tij natyrore (rekomandimi numër 15 nga Vendimi i Komitetit për Trashëgiminë Botërore 44.COM 7B.77 (Fuzhou, Kinë 2021), në kuadër të projektit Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në zonën e menaxhimit ndërkufitar me rrezik përmbytjeje në pellgun e lumit Drim, është përgatitur një zgjidhje teknike për kthimin e lumit Sateska në shtratin e tij të vjetër. Në gusht të vitit 2022, Sektori i Ujërave në MMJPH dorëzoi pëlqimin për menaxhimin e ujit për restaurimin dhe ridrejtimit e shtratit të lumit Sateska në rrjedhën e tij natyrore. Aktivitetet për zbatimin e tij janë në vazhdim.
- Lidhur me mbylljen e deponisë së Bukovës (Rekomandimi numër 16 i Vendimit 44.COM 7B.77) Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë dorëzuar kërkesë deri tek Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për shprehjen e interesit për financimin e Projektit për vendosjen e sistemit rajonal të menaxhimit të mbeturinave në rajonin Juglindor, Vardar, Pellagoni, Jugperëndimor dhe Pollog, me kredi në vlerë prej 55.367.614,00 euro dhe me këtë BERZH të jetë institucion financiar udhëheqës. Me sigurimin e këtyre mjeteve MMJPH do të vendosë sistemin në rajonin Jugperëndimor dhe në kuadër të aktiviteteve do të mbyllën të gjitha deponitë jostandarde në rajon(duke përfshirë Bukovën, Maucerin, Strugën etj).

SFIDAT QË MBETEN:

1. Mbajtja e debatit publik mbi Draft-Versionin e Planit Strategjik për rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit (21 nëntor 2022, nga ora 12:00 deri në ora 14:00 – platforma ZOOM).
2. Miratimi i Planit Strategjik për rehabilitimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit me plan veprimi të masave nga Qeveria e RMV-së - (deri në fund të dhjetorit 2022)
3. Mbajtja e një takimi të Komitetit Bilateral për Mbrojtjen e Liqenit të Ohrit të RMV-së dhe Shqipërisë për të pranuar një dokument të **përbashkët** Plani Strategjik për Rehabilitimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit (dhjetor 2022 - janar 2023)
4. Dorëzimi i dokumentit të **përbashkët** Plani Strategjik për Rehabilitimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Ohrit në Paris (shkurt 2023).

ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT do të kryhet në katër nivele dhe ato janë:

- niveli i parë - do të kryhet nga Komisioni për Menaxhimin e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore Botërore të Rajonit të Ohrit, përmes informatave/raporteve të dorëzuara rregullisht nga institucionet kompetente.
- niveli i dytë - do të kryhet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes themelimit të Komisionit të posaçëm, si organ i përhershëm, të cilit subjektet përgjegjëse për zbatimin e Planit Strategjik të Rehabilitimit do t'i dorëzojnë raport një herë në muaj.

-niveli i tretë - do të organizohet seancë mbikëqyrëse në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të jetë një mjet tjetër i përshtatshëm për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik për Rehabilitim me Planin e Veprimit.

- niveli i katërt - në nivel bilateral, kontrolli i zbatimit të Planit Strategjik të Rehabilitimit do të monitorohet nga Komiteti bilateral për Menaxhimin e Pellgut të Liqenit të Ohrit.

STRUKTURA E PLANIT TË MASAVE TË VEPRIMIT:

Masat ndahen në 4 grupe të përgjithshme sipas qëllimeve strategjike të cilave u referohen:

1. Qëllimi strategjik: Një sistem efektiv për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.
2. Qëllimi strategjik: Urbanizimi i kontrolluar dhe zhvillimi i qëndrueshëm
3. Qëllimi strategjik: Planifikimi i kontrolluar i infrastrukturës
4. Qëllimi strategjik: Planifikimi dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm

Në kuadër të planit, krahas ndarjes në kategori në lidhje me secilën masë, kryhet edhe:

- ✓ Lidhja e masës me rekomandimet përkatëse,
- ✓ Janë parashikuar nën-aktivitete të përshtatshme,
- ✓ Përcaktohet institucioni kompetent,
- ✓ Vlerësohet shkalla e realizimit,
- ✓ Përcaktohen treguesit për monitorimin e realizimit,
- ✓ Përcaktohet afati kohor i zbatimit.